

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e punëve të brendshme
Byroja për siguri publike
Njësia e policisë së uniformuar
Spektori për çështje komunikacioni

Numri: 22.2 - _____

Data: 13.05.2020

Deri te: Të gjitha autoshkollat dhe qendrat për provime në rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lënda: Njoftim, dërgesë, _

Në përputhje me obligimet që burojnë nga vendimet e miratuara në senacën e 51 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më datë 12.05.2020, respektivisht të miratimit të Planit për zvogëlimin e mesave restriktive për pengimin e përhapjes së koronavirusit, Ju njoftojmë se mes tjerash në seancën e Qeverisë është sjellë Vendim të fillojnë me aktivitete punuese, respektivisht të fillohet me realizimin e mësimit dhe trajnimeve nga ana e autoshkollave dhe realizimin e provimeve me kandidatët për vozitës nga ana e qendrave për provime në përputhje me protokollin për kryerjen e këtyre veprimtarive, në atë mënyrë që gjatë realizimit të aktiviteteve punuese është e nevojshme me konsekuencë të respektohen protokollet e Komisionit për sëmundje infektive të Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë drejtim, Ju njoftojmë se në Vendimin për masa për parandalimin dhe përhapjen e Koronavirusit COVID-19 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.62/20, 63/20, 64/20, 66/20, 70/20, 72/20, 92/20, 100/20, 107/20, 109/20 dhe 119/20), në nenin 1, paragrafi 1, në pikën 6 pas paragrafit 1 shtohet pragraf i ri 2, në rastin konkret Pika 24 ndryshohet dhe thotë:

SHTOJCA nr. 6, PROTOKOLL PËR PUNË TË SHKOLLAVE PËR TRAJNIMIN E VOZITËSVE

1. Përdorim i patjetërsueshëm i maskës mbrojtëse nga ana e kandidatit dhe instruktorit gjatë trajnimit në terren me automjet
2. Pas çdo trajnimi të secilit kandidat është i detyrueshëm dezinfektimi i pjesës së brendshme të automjetit
3. Organizimi i mësimit teorik në klasë me respektimin e masave për distancë fizike mes bankave nga 1.5m-2.0m dhe mbajtja e patjetërsueshme e maskave mbrojtëse nga ana e dëgjuesve dhe ligjeruesit
4. Vendsja e preparateve dezinfektuese dhe mbajtja e higjenës si dhe ajrosja pas çdo ligjerate të mbajtur
5. Tre persona është numri maksimal i personave në automjet gjatë realizimit të provimeve të kandidatit me mbajtjen e patjetërsueshme të maskës mbrojtëse nga të gjithë personat në automjet.

Në këtë drejtim, në lidhje me tekstin nga Pika e 5 e Shtojcës nr. 6 ua bëjmë me dije se në automjetin me të cilin mbahet pjesa e dytë praktike e provimit për leje, gjatë kohës së provimit-përveç kandidatit për vozitës mund të jenë prezentë kryetari dhe testatori i programit mësimor për pjesën praktike.

Kryeshef i Sektorit për çështje komunikacioni, Dejan Trajkovski, këshiltar i lartë policor